HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A
BORDI I DREJTORËVE

Nr. I/133
Datë: 29.08.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L -087 për Ndërmarrjet Publike, bazuar në Nenin 15.12 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, Nenin 20 të Statutit të HK-Trainkos Sh.A Nr. I/02, të dt. 19.01.2024, si dhe Nenin 1 të Rregullores për Punën e Komiteteve të Bordit të Drejtorëve Nr. I/207, të dt. 30.11.2015, Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A në Mbledhjen Nr. 11, të mbajtur më 29.08.2024, njëzëri mori këtë:

VENDIM

I. Formohet Komiteti për Hulumtime dhe Teknologji i Bordit të Drejtorëve të HK-Trainkos Sh.A., në këtë përbërje:
   1. Z. Afrim Bulluti, kryesues
   2. Znj. Luljeta Lutfiu, anëtare
   3. Z. Agron Statovci, anëtar
   4. Z. Altin Podrimçaku, këshilltar

II. Komiteti për Hulumtime dhe Teknologji detyrat e tij do t'i kryejë në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për NP-të në Kosovë, Kodin e Etikës, Statutin dhe rregulloret tjera të aplikueshme në Ndërmarrje.

III. Puna dhe angazhimi i Komitetit do të jetë pa kompensim.

IV. Për punën e këtij komiteti, HK-Trainkos Sh.A do të ofrojë kushtet e nevojshme.

V. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Për Bordin e Drejtorëve

Jetmir NUKA – Kryesues

Iu dërgohet:

- Aksionarit – NJPMNP
- Anëtarëve të komitetit
- Sektorit të Burimeve Njerëzore
- Arkivit